



**URDHËR**

Nr. 55, Datë 19.09.2013

**MBI MIRATIMIN E MODELIT TË KËRKESËS PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMI PËR PAGESËN VJETORE TË STUDIMIT PËR STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2013 - 2014**

Mbështetur në nenin 39 të Statutit të Universitetit të Arteve, duke mbajtur në parasysh përcaktimet e VKM 565, datë 27.06.2013 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2013-2014", si dhe VKM 744, datë 05.09.2013 "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, "Master profesional" dhe "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura", për vitin akademik 2013 - 2014",

**URDHËROJ**

1. Miratimin e modelit të Kërkesës për përjashtimin nga detyrimi për pagesën vjetore të studimit për studentët që ndjekin studimet në Universitetin e Arteve, sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur këtij urdhri. Studentët që plotësojnë një apo më shumë nga kriteret e përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave mund të paraqesin kërkesë për përjashtim nga detyrimi për pagesën vjetore të shkollimit, vetëm duke plotësuar formularin sipas këtij urdhri.
2. Aplikimi për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, do të bëhet deri në datën 30 dhjetor 2013, për të gjithë studentët e regjistruar në regjistrimet fillestare, në Zyrën e Protokollit të UART. Aplikimi duhet të dorëzohet detyrimisht dorazi tek punonjësja e zyrës së protokollit.
3. Çdo aplikim i cili nuk është dorëzuar dorazi tek punonjësja e protokollit nuk do të merret në shqyrtim.
4. Studentët, të cilët janë regjistruar me shtesat kanë të drejtë të aplikojnë deri në datën 15 janar 2014.
5. Çdo kërkesë që paraqitet përtej afateve të përcaktuara në pikat 2 dhe 4 më sipër, nuk do të pranohet.
6. Zyra e Protokollit në momentin e dorëzimit të kërkesës nga studentët/kërkuesi udhëzon kërkuesin të interesohet pranë sekretarive të Fakulteteve lidhur me pranimin ose jo të kërkesës së paraqitur.
7. Zyra e protokollit i regjistron kërkesat në një regjistër të veçantë, sipas Lidhjes 2.




8. Kërkesat e regjistruara rregullisht i dorëzohen Degës Juridike, jo më vonë se 3 ditë nga data e regjistrimit të tyre.
9. Dega Juridike shqyrton kërkesat e paraqitura dhe verifikon dokumentacionin shoqërues të çdo kërkesë. Në fletën e posaçme Dega Juridike bën shënimet përkatëse lidhur me kohën e paraqitjes së kërkesës, pranueshmërinë e kërkesës dhe rregullshmërinë e dokumentacionit shoqërues, si dhe përmbushjen e kritereve për përjashtim nga tarifa e shkollimit.
10. Dega Juridike verifikon dokumentacionin dhe brenda 3 ditëve i kthen zyrës së protokollit kërkesat e paraqitura së bashku me shënimet përkatëse. Zyra e protokollit i paraqet kërkesat tek Rektori i UART, për nxjerrjen e urdhrit të miratimit apo mosmiratimit të kërkesës.
11. Zyra e Protokollit pas regjistrimit numrin dhe datën e urdhrit të Rektorit për miratimin apo mosmiratimin e kërkesës, i dërgon Sektorit të Informacionit dhe Statistikës kopje të çdo praktike të nënshkruar (të miratuar apo mosmiratuar) nga Rektori, pa dokumentacionin shoqërues.
12. Çdo strukturë tjetër e UART që kërkon informacion statistikor mbi përjashtimin e studentëve nga detyrimi për pagesën vjetore të shkollimit i drejtohet Sektorit të Informacionit dhe Statistikave me anë të një kërkesë me shkrim.
13. Zyra e Statistikës dhe Informacionit përgatit një tabelë të posaçme sipas Lidhjes 3, bashkëlidhur këtij urdhri. Kopje elektronike e tabelës i dërgohet Sekretarive mësimore të tre Fakulteteve, Degës Juridike dhe Drejtorisë Ekonomike.
14. Kopja elektronike dërgohet çdo 3 ditë, me përditësimet përkatëse (tabela dërgohet e plotë me të gjitha të dhënat deri ditën që dërgohet tabela).
15. Sekretaritet e Fakulteteve në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelë kanë detyrimin që ti japin informacion çdo studenti lidhur me miratimin ose jo të kërkesës së paraqitur prej tij/saj.
16. Studenti, kërkesa e të cilit nuk është miratuar, duhet të paraqitet në zyrën e protokollit dhe të njihet me arsyet e mospranimit të shënuara në kërkesën për aplikim. Studentit i dorëzohet kopja e dytë e urdhrit të Rektorit, e cila mban shënimin "Kopje për studentin".
17. Në rastet kur kërkesa nuk është miratuar për shkak të mangësive në dokumentacionin e paraqitur, atëherë studenti kërkues ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re, duke plotësuar formularin e kërkesës nga e para dhe duke bashkëlidhur vetëm dokumentacionin e munguar. Në këtë rast studentit duhet t'i bashkëlidhë kërkesës së re edhe urdhrin e mosmiratimit të kërkesës së mëparshme.
18. Në çdo rast kërkesat e reja paraqiten brenda afateve të përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të këtij urdhri.



19. Në çdo rast dokumentacioni shoqërues i kërkesës duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar, me përjashtim të letërnjoftimit të studentit i cili mund të jetë fotokopje. Dokumenti jo origjinal i panoterizuar nuk do të merret në konsideratë në shqyrtimin e kërkesës dhe mund të çoj në mosmiratimin e kërkesës.
20. Kërkesa duhet të plotësohet në të gjitha fushat e saj, në të kundërt kërkesa nuk do të miratohet.
21. Në rastin e studentëve kërkues sipas kriterit 8, dokumentacioni i dorëzuar do të jetë konfidencial dhe nuk do të bëhet publik. Strukturat të cilat trajtojnë dokumentacionin janë përgjegjëse për mbajtjen e konfidencialitetit. Studenti kërkues, sipas kriterit në momentin e paraqitjes së kërkesës konsiderohet se pranon njohjen e të dhënave nga strukturat e UART që trajtojnë dokumentacionin e kërkesës, në përputhje me përcaktimet e këtij urdhri.
22. Në përfundim të afateve të përcaktuara në pikat 2 dhe 4 të këtij urdhri, për dorëzimin e aplikimeve nga ana e studentëve, si dhe pas përfundimit të procesit të përpunimit të kërkesave dhe nxjerrjes së urdhrin përkatës, do të kryhet verifikimi i dokumentacionit të aplikimeve *a posteriori*. Procesi i verifikimit do të realizohet nga Dega Juridike dhe Dega e Auditit të Brendshëm. Për verifikimin e dokumentacionit do të merret informacion edhe nga institucione apo subjekte të treta të cilat kanë lëshuar dokumentacionin.
23. Në rastet kur konstatohet se një aplikim përmban dokumente jo të vërteta, atëherë Rektori do të revokojë urdhrin për miratimin e kërkesës përkatëse të paraqitur nga studenti dhe do të njoftohet studenti përkatës për të kryer pagesën e tarifës vjetore të shkollimit brenda 10 ditëve nga data e njoftimit. Mospagesa brenda afatit 10 ditor sjellë ndërprerjen e studimeve të studentit.
24. Ky urdhër i shpërndahet sekretarive mësimore të fakulteteve dhe shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve. Sekretaritë mësimore të Fakulteteve udhëzojnë studentët që të shkarkojnë modelin e kërkesës nga faqja zyrtare e UART [www.uart.edu.al](http://www.uart.edu.al), në rubrikën "Njoftime" ose në rubrikën "Studentët".
25. Ngarkohen Sekretaritë e Fakulteteve, Zyra e Protokollit, Dega Juridike, Dega e Statistikës dhe Informacionit dhe studentët e Universitetit të Arteve për zbatimin e këtij urdhri.
26. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ  
  
REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE

KËRKESË PËR PËRJASHTIM NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT				 REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE			
Kjo praktikë hartohet në baze të përcaktimeve të VKM nr. 565, date 27.06.2013 dhe VKM 744, dt. 05.09.2013. Kjo praktikë nuk përdoret për studentët që janë shtetas të huaj.				NUMRI I PROTOKOLLIT PLOTËSOHET <u>VETËM</u> NGA ZYRA E PROTOKOLLIT E UART			
				Nr. _____ prot.			
				Datë _____			
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X, ose rrumbullako)							
Emri				Data e kërkesës			
Mbiemri				Nr. i Letër njoftimit			
Atësia				Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>	
Datëlindja	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	Cikli i studimit	1	2	
	dita	muaji	viti	Viti i Studimit	1	2	3
Fakulteti	FM	FAS	FAB	Programi i Studimit			
Lloji i kërkuar i përjashtimit nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit				I PLOTË	<input type="checkbox"/>	I PJESHËM	<input type="checkbox"/>
<p>Unë kërkesi paraqes KËRKESË për përjashtimin tim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student i Universitetit të Arteve dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga vendimet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë tarifën vjetore të shkollimit në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë si dhe dokumentacioni shoqëruar që provon plotësimin e njërit prej kushteve të renditura në vijim në këtë kërkesë, janë, në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumenta zyrtarë të marra nga institucionet shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.</p> <p>Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë sjellin automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe në këtë rast detyrimin tim që brenda 10 ditësh nga njoftimi i bërë nga strukturat e UART, të kryej pagesën e kësaj tarife, në të kundërt humbas të drejtën e vazhdimin të studimeve.</p> <p>Dokumentet shoqëruar janë origjinale ose kopje të noterizuara, sipas kërkesave në këtë formular. (Dokumentacioni duhet të provojë plotësimin e kushteve në momentin e aplikimit.).</p>							
KËRKUESI				NËNSHKRIMI			
_____				_____			
Emri dhe mbiemri							


Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj



<b>Kriteri 1</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: persona që nuk shikojnë/ nuk dëgjojnë</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vërtetim nga KMCAJ;</li> <li>- Fotokopje të letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 2</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: invalidë pune dhe fëmijët e tyre, invalidë paraplegjikë apo tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë familjare e kërkuesit që vërteton lidhjen familjare;</li> <li>- Vërtetim nga KMCAJ për prindin/studentin e deklaruar invalid pune ose paraplegjik apo tetraplegjik;</li> <li>- Dëshmi e Invalidit të Punës (vetëm për rastin invalid pune);</li> <li>- Vërtetim nga ISSH për pagesën e pensionit të invaliditetit të punës (vetëm për rastin invalid pune);</li> <li>- Fotokopje të letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 3</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: jetimë (kur të dy prindërit kanë ndërruar jetë)</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë vdekje të secilit prind;</li> <li>- Çertifikatë e studentit;</li> <li>- Fotokopje të letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 4</b>	<b>Student të cilit njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familja e tij përfiton ndihmë ekonomike nga njësia e qeverisjes vendore ose vjen nga "familje në nevojë"</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë vdekje e prindit;</li> <li>- Çertifikatë familjare e studentit ;</li> <li>- Vërtetim nga Njësia e Qeverisjes Vendore që përfiton ndihmë ekonomike ose vërtetim që hyn në kategorinë "familje në nevojë"</li> <li>- Fotokopje të letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 5</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë romë / ballkano egjiptianë</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vërtetim nga shoqata e komunitetit përkatës;</li> <li>- Fotokopje të Letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 6</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë nga prindër të dënuar politik me heqje lirie</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë familjare e kërkuesit që vërteton lidhjen familjare;</li> <li>- <u>Vetëm për studentët e ciklit të parë:</u> Vendimi për dënimin me heqje lirie të prindit dhe/ose Vendimin e njohjes së statusit të të përndjekurit politik për shkak të dënimit me heqje lirie.</li> <li>- <u>Vetëm për studentët e ciklit të dytë:</u> Vendimi për dhënien e statusit të të përndjekurit politik për të paktën njërin nga prindërit.</li> <li>- Fotokopje të Letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>
<b>Kriteri 7</b>	<b>Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë të policëve e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës</b>
<input type="checkbox"/>	Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë familjare e studentit kërkues ;</li> <li>- Vërtetim nga autoriteti shtetëror përkatës (Ministria e Mbrojtjes apo Ministria e Brendshme apo strukturat e tyre të autorizuar) që vërteton se prindi i studentit është/ka qenë efektiv i tyre dhe ka rënë në krye të detyrës apo është plagosur për shkak të detyrës;</li> <li>- Fotokopje të Letërnjoftimit të studentit kërkues.</li> </ul>

Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj



<p style="text-align: center;"><b>URDHËR</b> <b>MBI KËRKESËN PËR PËRJASHTIM NGA DETYRIMI</b> <b>PËR PAGESËN E TARIFËS VJETORE TË</b> <b>SHKOLLIMIT</b></p>		<p style="text-align: center;"><b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> <b>UNIVERSITETI I ARTEVE</b> <b>REKTORI</b></p>
<p>Në bazë të Mbështetur në nenin 39 të Statutit të Universitetit të Arteve, duke mbajtur në parasysh përcaktimet e VKM 565, date 27.06.2013 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2013-2014", si dhe VKM 744, date 05.09.2013 "Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plote, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", për vitin akademik 2013 - 2014", VËREJ SE</p>	<p>Numri i protokollit plotësohet nga Zyra e Protokollit e UART</p>	
<p style="text-align: center;">Studenti / Studentja</p> <p>_____</p> <p style="text-align: center;">Emri Atësia Mbiemri (ME GËRMA TË MËDHA)</p>	<p>që ndjek studimet në UART në :</p> <p style="text-align: center;"> <input type="checkbox"/> FM      <input type="checkbox"/> FAS      <input type="checkbox"/> FAB         </p>	
<p>në bazë të dokumentacionit të dorëzuar ka kërkuar përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, duke qenë se i përket shtresës sociale:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Persona që nuk shikojnë;</li> <li>2. Persona që nuk dëgjojnë;</li> <li>3. Invalidë pune ose fëmijë të tyre;</li> <li>4. Invalidë paraplegjikë ose fëmijë të tyre;</li> <li>5. Invalidë tetraplegjikë ose fëmijë të tyre;</li> <li>6. Jetimë;</li> <li>7. Studentë pa një prind dhe përfitues të ndihmës ekonomike ose familje në nevojë</li> <li>7. Fëmijë romë;</li> <li>8. Fëmijë ballkano-egjiptian;</li> <li>9. Fëmijë nga prindër të dënuar politik me heqje lirie / me status e ish të përndjekurit politik;</li> <li>10. Fëmijë të policëve apo ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur në krye të detyrës</li> <li>11. Student i prekur nga sëmundja HIV/AIDS</li> <li>12. Student i shkëlqyer apo student me medalje ari</li> </ol>		
<p>Nga dokumentet e paraqitura arrihet në përfundimin se student i kërkuar:</p> <p>I plotëson <input type="checkbox"/>      nuk i plotëson <input type="checkbox"/></p> <p>kriteret për përjashtimin nga detyrimi për pagimin e tarifës vjetore të shkollimit.</p>	<p>Për këtë arsye kërkesa e paraqitur nga student i</p> <p>MIRATOHET      NUK MIRATOHET</p> <p>I PLOTË <input type="checkbox"/>      <input type="checkbox"/></p> <p>I PJESSHËM <input type="checkbox"/>      <input type="checkbox"/></p>	
<p><b>KUJDES:</b></p> <p>Në këtë faqe student i plotëson me germa të mëdha VETËM emrin, atësinë dhe mbiemrin, si dhe rrumbullakos Fakultetin përkatës ku studion. Pjesa tjetër është për përdorim nga Rektori. Çdo shënim jashtë pjesës së caktuar për plotësim nga student i bën kërkesën të PAVLEFSHME.</p>	<p style="text-align: right;">Prof. Petrit MALAJ</p> <p style="text-align: right;">_____</p> <p style="text-align: right;">REKTOR UNIVERSITETI I ARTEVE</p>	

Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj

ARSYET E MOSMIRATIMIT TË KËRKËSËS PËR  
PËRJASHTIM NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E  
TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

(KJO PJESË ËSHTË VETËM PËR SHËNIME NGA ADMINISTRATA E UART)

Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj



<p style="text-align: center;"><b>URDHËR</b> <b>MBI KËRKESËN PËR PËRJASHTIM NGA</b> <b>DETYRIMI PËR PAGESËN E TARIFËS VJETORE TË</b> <b>SHKOLLIMIT</b></p>		<p style="text-align: center;"><b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> <b>UNIVERSITETI I ARTEVE</b> <b>REKTORI</b></p>
<p>Në bazë të Mbështetur në nenin 39 të Statutit të Universitetit të Arteve, duke mbajtur në parasysh përcaktimet e VKM 565, datë 27.06.2013 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohe të plotë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2013-2014", si dhe VKM 744, datë 05.09.2013 "Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohe të plote, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave"/"Master i Arteve të Bukura", për vitin akademik 2013 - 2014", VËREJ SE</p>	<p>Numri i protokollit plotësohet nga Zyra e Protokollit e UART</p>	
<p style="text-align: center;">Studenti / Studentja</p> <p>Emri Atësia Mbiemri (ME GËRMA TË MËDHA)</p>	<p style="text-align: center;">që ndjek studimet në UART në :</p> <p style="text-align: center;"> <input type="checkbox"/> FM      <input type="checkbox"/> FAS      <input type="checkbox"/> FAB         </p>	
<p>në bazë të dokumentacionit të dorëzuar ka kërkuar përjashtimin e plotë ose të pjesshëm nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, duke qenë se i përket shtresës sociale:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Persona që nuk shikojnë;</li> <li>2. Persona që nuk dëgjojnë;</li> <li>3. Invalidë pune ose fëmijë të tyre;</li> <li>4. Invalidë paraplegjikë ose fëmijë të tyre;</li> <li>5. Invalidë tetraplegjikë ose fëmijë të tyre;</li> <li>6. Jetimë;</li> <li>7. Studentë pa një prind dhe përfitues të ndihmës ekonomike ose familje në nevojë</li> <li>8. Fëmijë romë;</li> <li>9. Fëmijë ballkano-egjiptian;</li> <li>10. Fëmijë nga prindër të dënuar politik me heqje lirie / me status e ish të përndjekurit politik;</li> <li>11. Fëmijë të policëve apo ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës</li> <li>12. Student i prekur nga sëmundja HIV/AIDS</li> <li>13. Student i shkëlqyer apo student me medalje ari</li> </ol>		
<p>Nga dokumentet e paraqitura arrihet në përfundimin se student i kërkuar:</p> <p>I plotëson <input type="checkbox"/>      nuk i plotëson <input type="checkbox"/></p> <p>kriteret për përjashtimin nga detyrimi për pagimin e tarifës vjetore të shkollimit.</p>	<p>Për këtë arsye kërkesa e paraqitur nga student i</p> <p>MIRATOHET      NUK MIRATOHET</p> <p>I PLOTË <input type="checkbox"/>      <input type="checkbox"/></p> <p>I PJESSHËM <input type="checkbox"/>      <input type="checkbox"/></p>	
<p><b>KUJDES:</b></p> <p>Në këtë faqe studenti plotëson me germa të mëdha VETËM emrin, atësinë dhe mbiemrin, si dhe rrumbullakos Fakultetin përkatës ku studion. Pjesa tjetër është për përdorim nga Rektori. Çdo shënim jashtë pjesës së caktuar për plotësim nga student i bën kërkesën të PAVLEFSHME.</p>	<p style="text-align: right;">Prof. Petrit MALAJ</p> <p style="text-align: right;">REKTOR UNIVERSITETI I ARTEVE</p>	

**KOPJA PËR STUDENTIN**

Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj

ARSYET E MOSMIRATIMIT TË KËRKESËS PËR  
PËRJASHTIM NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E  
TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

(KJO PJESË ËSHTË VETËM PËR SHËNIME NGA ADMINISTRATA E UART)

KOPJA PËR STUDENTIN

Shënim: Mosplotësimi i të gjithë fushave të kërkesës përbën shkak për refuzimin e saj





